



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Buxhet dhe Financa
Direktorat za Budžet i Finansije


Data/Datum/Date:	19.08.2025
Nr./Br./No	11/128
Për/Za/To:	Komiteti per Politik dhe Financa Kuvendi Komunal Shtime
Përmes/Preko/Through:	Qemajl Aliu, Kryetar i Komunës
Nga/Od/From:	Besnik Ahmeti; Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa Znj. Kimete Ukaj; ZKF; Komuna e Shtimes
Lënda/Predmet/Subject :	Plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve nga ZKA për Pasqyrat Vjetore Financiare të vitit 2024

Të nderuar,

Më lejoni që përmes kësaj shkrese sipas nenit 23, pika 5 të Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyren Kombëtare të Audimit, çdo Institucion i audituar është i obliguar ta dorëzoj planin e veprimit ku përcaktohen se si do t'i adresoj rekomandimet e dhëna në raport.

Të bashkangjitur gjeni dokumentin e planit të veprimit.

Me respekt



për Zyrën Kombëtare të Auditimit
Nga z.Qemajl Aliu, Kryetar i Komunitës
Date: 07.07.2025, Shkronje

PLAN I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE
të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra
Kombëtare e Auditimit

Nr.	Komponenta e auditimit(kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
Gjetjet dhe rekomandimet nga viti 2024							
1	A1 - Vonesa në pagesën e obligimeve financiare	Sipas LMFP-së Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit neni 39 përcaktohet se ZKF i Organizatës Buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për OB- në të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim. Në pesë (5) raste, faturat në vlerë totale prej 34,482€, kanë të bëjnë me obligime të papaguara, duket tejkualuar afatin ligjor prej 30 ditë, ku vonesat janë deri në 453 ditë. Këto fatura kanë të bëjnë me: shërbimet fotografike për aktivitete (1,378€), furnizim me ushqim dhe pije me rastin e organizimit të festave nga Komuna (479€ dhe 990€), zbatimin e masave të eficientës (15,050€), dhe obligimet përmes vendimit gjyqësor për pagane (16,584€). Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve jo adekuate në ekzekutimin e pagesave dhe menaxhim të kontratave publike, ku nuk ka pasur planifikim të duhur të buxhetit për	Kryetari duhet të forcojë kontrollin e menaxhimit të faturave, duke siguruar se pagesat bëhen brenda afatit të përcaktuar ligjor	Hapi i Parë : Identifikimi i obligimeve sipas faturave të pranuar Hapi Dytë: Planifikimi buxhetor . Hapi i Tretë: Ekzekutimi i tyre në afate kohore.	Drejtorët e drejtorive Menaxherët e kontratave ZKF	TM3 – TM4 2025	

		këto obligime.		Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë me një mbikëqyrje rigoroze në menaxhimin e kontratave. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat/ndëshkimet e parapara në kontratë	Hapi i parë:Evidentimi i kontratave të nënshkruar nga drejtorët e drejtorive për secilin projekt sipas drejtorisë përkatëse. Hapi dytë:Caktimi i mbyqyrësve Hapi i Tretë:Raportimi i rregullt i projekteve siopas fazave apo dinamike të kryerjes së punëve apo furnizimeve ,sherbimeve. Hapi katërt :Harmonizimi me planin e shpenzimeve drejtorin e financave dhe finalizimi i tyre	-Drejtorët e drejtorive -Menaxheri i prokurimit -Menaxherët e Kontratave	TM3 – TM4 2025	
2	A2 - Vonesa në në realizimin e projektit kapitalë	Sipas Rregullës Nr. 001-2022 për prokurimin publik, neni 70.23 menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me temat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Në kontratat e lidhura ndërmjet komunës dhe operatorëve ekonomik, janë përcaktuar afatet kohore të realizimit të kontratave. Në bazë të mostrave të testuara në një (1) rast kemi vërejtur se punimet nuk ishin realizuar konform planit dinamik siç parashihej me kontratë, ku: Kontrata "Rregullimi i murit mbrojtës në Reçak afer Kompleksit dhe asfaltimi i rrugëve rr. 15 Janari rr. Pavarstia, kanalizimi në rr. Deshmoret e Reçakut-Ri-Tenderim" në vlerë 69,435€ nuk është kryer sipas planit të paraparë dinamik prej 11 muaj. Vonesa për këtë kontratë ishte 40 ditë. Mangësitë e identifikuar kishin ardhur si rezultat i mos-funksionimit të kontrolleve të brendshme në procesin e menaxhimit të projektit për tu siguruar që projekti të realizohet sipas planit dinamik	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasurit në vijim të regjistruara në regjistra kontabël të komunës janë mbyllur dhe të regjistrohen si pasuri sipas klasave	Hapi i parë:Identifikimi i investimit në vijim të mbylles apo finalizohen projektet të cilat janë përfunduar.	Drejoria Buxhet dhe Financa ZKF Drejtoria e prokurimit	TM3 – TM4 2025		
3	A3 - Mos mbyllja e investimeve në vijim	Sipas nenit 6 të Rregullores Nr. 02/2013 “Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 11 thuhet se pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasurit në vijim të regjistruara në regjistra kontabël të komunës janë mbyllur dhe të regjistrohen si pasuri sipas klasave	Hapi i parë:Identifikimi i investimit në vijim të mbylles apo finalizohen projektet të cilat janë përfunduar.	Drejoria Buxhet dhe Financa ZKF Drejtoria e prokurimit	TM3 – TM4 2025		

		zhvlerësimi.	përkatëse				
		Sipas analizës së regjistrimit kontabël të pasurive kapitale është vërejtur se në kuadër të kodit ekonomik “32500 Investimet në vijim” nuk janë mbyllur projektet të cilat janë finalizuar, ku nga viti 2016 deri në vitin 2020 ishin në vlerë prej 630,056€. Mangësitë e identifikuar kishin ardhur si rezultat i mos-funksionimit të kontrolleve të brendshme në procesin e menaxhimit të pasurive kapitale					
4	A4 - Mangësi në raportimin e rregullt për shfrytëzim të pronave komunale	Neni 22 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, përcakton se “Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjatë (6) mujore t’i paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim”. Komuna kishte përgatitur raporte të rregullta gjatë (6) mujore, mirëpo këto raporte nuk përmbanin informata lidhur me monitorimin e realizimit të kontratave që kanë të bëjnë me dhënie në shfrytëzim të pronave komunale. Edhe në vitin 2024, komuna kishte lidhur katër (4) kontrata të reja për shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale si dhe kishte ripërtërirë tri (3) kontrata tjera, por nuk kishte raportuar për qëllimin e dhënies në shfrytëzim dhe mbikëqyrjes së tyre. Kjo vjen si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efektive, mos përgjegjësisë së zyrtarëve	Kryetari duhet të sigurojë se raportet rregullta gjatë (6) mujore të përmbajnë edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.	Hapi i parë: Formimi i komisionit komunal për vlerësimin dhe shqyrtimin e zbatueshmërisë praktike të pronave të cilat janë dhënë në shfrytëzim. Hapi i dytë: Identifikimi dhe monitorimi i pronave të cilat janë dhënë në shfrytëzim sipas kontratave të nënshtruara. Hapi tretë: Përgatitja e një raporti detaj për pronat komunale të dhëna në shfrytëzim.	Kryetari Drejtorja për Zhvillim Ekonomik	TM3 – TM4 2025	

		përkatës të komunës për të zbatuar kërkesat e ligjore në lidhje me shfrytëzimin pronave komunale nga qiramarrësit.			Hapi katërt : Raportimi në kuvend për punën e komisionit mbi realizimin e kontratave dhe përbushjes tyre			
5	A5 - Mangësi në bazën e të dhënave të tatimit në pronë	Ligji Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Neni 12, thekson se komuna ka përgjegjësi për regjistrim dhe menaxhim të të dhënave të tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë ashtu siç përcaktohet në aktin nënligjor. Përveç kësaj, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë, ka njoftuar komunat për vendimin e marrë për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, me qëllim të shmangies së dyfishimeve/apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni. Gjatë analizës së bazës së të dhënave të tatimit në pronë është identifikuar se 7,883 tatimpagues individual nuk kanë të prezantuar numrat personal në këtë bazë. Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e mos verifikimit të pronave në fjalë dhe mos azhurnimit të shënimeve në sistemin e tatimit në pronë nga njësitë komunale e tatimit në pronë.	Kryetari duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve.	Hapi i parë: Pregaditja e raporteve për objekte dhe parcela nga PROTAX . Hapi dytë: Identifikimi i tatimpaguesve pa numër personal në program . Hapi tretë: Ndërmarrja e masave paraprake për plotsimin e numrave personal sa të jetë e mundur.	Drejtorja për buxhet dhe financa Menaxheri i tatimit në pronë Operatorët Teknik	TM3 – TM4 2025		
Gjetjet dhe rekomandimet nga viti 2023=Të përsëritura								
I	B1 - Klasifikimi jo	Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike”. nenit 18 pikës 3 të Shpenzimit duhet të kenë	Kryetari duhet të sigurojë se	Hapi i parë: Evidentimi i Obligimeve të	Drejtorja për Buxhet dhe Financa-	TM3 – TM4 2025		

	adekuat i shpenzimeve	kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet të aplikojnë. Në bazë të pagesave të testuara, kemi vërejtur se janë bërë pagesa nga kodet joadekuate, në vlerë prej 461,764€. Nga kjo vlerë thesari kishte paguar sipas vendimit përbarimor/të gjykatës për paga jubilarë, shujta dhe kualifikim për arsimtar nga kategoria investimet kapitale 278,840€, nga mallra shërbime dhe komunal 132,209€ dhe nga Subvencione dhe transfere 50,716€. Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive, shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në kategoritë përkatëse ekonomike.	shpenzimet planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV.	cilat rrjedhin nga kontrata kolektive dhe klasifikimi i tyre, në ato të cilat i kanë përfunduar të gjitha procedurat dhe ato obligime të cilat janë në proces . Hapi i dytë: Trajtimi me departamentin e thesarit të kësaj teme -Obligimet kontigjente si hapja e Kodeve të reja,apo edhe rritja e buxhetit në kategorin e pagave. Hapi i Tretë: Pregaditja e KAB për vitin vijues dhe kodimi i mjeteve për pagesen e obligimeve të cilat kanë kaluar të gjitha proceset.	ZKF	Zyra Ligjore .		
2.	B2 - Ndarija e subvencioneve duke mos respektuare kriteret e thirrjes	Sipas nenit 23 paragrafi 2 Rregullorja MF-Nr.04/2017-mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatës Jo Qeveritare (OJQ), Përfutuesi raporton te zyrtari monitorues, përkatësisht ekipi monitorues, në baza të rregullta, lidhur me zbatimin e projektit/programit, sipas kërkesave të kontratës së përcaktuar në nenin 22 të kësaj Rregulloreje. Raportimi		Hapi i Parë: Pregaditja e planit vjetor për ndarjen e subvencioneve . Hapi i dytë: Formimi i komisionit për	Drejtorit përkatëse të cilat në buxhetin e aprovuar kanë mjete në kategorinë e subvencioneve	TM3 – TM4 2025		

publike dhe mos raportim i sipas kërkesave ligjore	përfshin raporte narrative dhe financiare dhe periudhat raportuese do të përcaktohen me dispozitat e kontratës me përfituesin. Neni 4 i kontratës ndemjet komunës dhe përfituesit e obligon përfituesin të përgatit raportin financiar për njetet e shpenzuara dhe raportin narrativ për aktivitetet e realizuara si dhe të gjitha shpenzimet me vlerë mbi 500 duhet të bëhen vetëm përmes transferit bankar. Po ashtu thirrja publike Nr.09/34 e datës 16.02.2024 për mbështetje financiare për projektet ne zhvillimin dhe masivizimin e sportit përcakton kriteret për aplikim. Komuna gjatë viti 2024 kishte ndarë subvencione për mbështetjen e "OJQ- ve, Klubeve sportive të Futbollit ,Futballit dhe për aktivitete kulturore/ansamble" në vlerë prej 34,800€, këto aktivitete kanë të bëjnë me përkrabjen e klubeve në gara të ndryshme sportive dhe ansamble në aktivitete kulturore. Mbështetja financiare për klubet e Futbollit në vlerë 20,000€, Futballit në vlerë 10,000€ dhe Ansambllit të këngëve dhe valleve në vlerë 4,800€. Gjatë testimit të mostrave kemi vrejtur se dy (2) OJQ/Klube sportive kanë përfituar subvencione pa plotësuar kriteret e thirrjes publike. Gjatë testimit të mostrave kemi vrejtur se dy (2) OJQ/Klube sportive kanë përfituar subvencione pa plotësuar kriteret e thirrjes publike. rregullores i cili nuk përshkruan aktivitetet e realizuara. Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme dhe mungesës së përgjegjësisë për zbatimin e kërkesave ligjore lidhur me subvencionimin e		ndarjen e subvencioneve . Hapi tretë: Thirrjet publike dhe specifikimi i detaizuar për aplikim duke u mbështetur Rregulloren e brendshme të komunës për ndarjen e subvencioneve . Hapi i katërt: Njoftimi i përfituesve me rregulloren për ndarjen e subvencioneve dhe ligjet të cilat e rregullojnë këtë		
--	--	--	--	--	--

		OJQ-ve	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e mbështetjes financiare ndaj OJQ-ve të respektohen kriteret e thirrjes publike, dhe OJQ-të përfitues të dorëzojnë raporte financiare dhe narrative në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.				
3	B3 - Dobësi në menaxhimin e kontratave përmes platformës elektronike të e-prokurimit	Sipas të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik neni 70.24 pika (f) parasheh se menaxherët e kontratës “Të sigurojnë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik. Në bazë të mostrave të testuara, në pesë (5) raste, menaxhimi i kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontraktuesve nuk është mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik (e-prokurimi), si Rregullimi i Tregut të Hapur në Qytetin e Shtimes-Faza II në vlerë 299.584€. Rregullimi i Tregut të Hapur në Qytetin e Shtimes-Faza II në vlerë 299.584€. Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efektive në procesin e menaxhimit të kontratave	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik.	Hapi i parë: Zyra e prokurimit të angazhohet vazhdimisht për menaxhimin e kontratave përmes platformës E-Prokurimi . Hapi i Dytë: Kërkesa për trajnime shtesë nëse është e nevojshme për menaxhimin e kontratave përmes Platformës E-Prokurimi	Kryetari Drejtoria e prokurimit Menaxheri i prokurimit	TM3 – TM4 2025	

		brendshme jo efikase në menaxhimin përkatesisht arkëtimin e tyre.							
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Vërejtje: Ky raport ka rezultuar me (nëntë) 9 rekomandime, prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja dhe katër (4) të përsëritura, rekomandimet me shkronjën A janë rekomandime të reja ,ndërsa rekomandimet me shkronjën B janë të vitit paraprak .